

Decentralizimi etnik në Kosovë

*Donik Sallova**

Abstrakt

Shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 u bazua në të ashtuquajturën “Pako e Ahtisarit”, e cila u përgatit nga i dërguari i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Marti Ahtisari. Kushtet themelore të kësaj “pakoje” kishin të bënin me natyrën demokratike dhe multietnike të shtetit të Kosovës, ndërsa në mënyrë të veçantë ato lidheshin me garantimin e të drejtave të pakicave kombëtare ose siç i referohet dokumenti “komuniteteve pakicë”. Kjo pako prezumon se nëpërmjet decentralizimit të qeverisjes lokale dhe themelimit të komunave të reja ku jetojnë pakicat, të garantohet vetëqeverisja, si proces i pranimit dhe integritit të tyre në shtetin e Kosovës. Qëllimi i këtij punimi është të argumentojë se decentralizimi dhe themelimi i komunave të reja, veçanërisht për komunitetin serb në Kosovë, më shumë se sa të ndihmojë në vetëqeverisje, ka çuar në dezintegrimin dhe izolimin e tyre, duke thëlluar akoma më shumë ndarjen me shumicën etnike në Kosovë. Marrëveshja për themelimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe e arritur në gushtin e vitit 2015 në Bruksel demonstroi tendencën e komunave serbe për t’u lidhur me njëra-tjetrën në një entitet autonom politik, si fazë paraprake drejt bojkotit të përgjithshëm të shtetit të Kosovës.

Fjalë kyç: *decentralizim, etnik, qeverisje, shqiptarë, serbë.*

Hyrje: Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë si vetëqeverisje përtej pushtetit lokal

Nënshkrimi i Marrëveshjes për Themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe

* PhD Candidate, Ligjërues i rregullt në Kolegjin AAB. E-mail: donik.sallova@aab-edu.net

ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Bruksel (gusht 2015), nën ndërmjetësimin e shefes së BE-së për Politikë të Jashtme Frederica Mogherini, u interpretua në dy kontekste në Kosovë dhe Serbi. Establishmenti politik i Kosovës i cili e nënshkroi këtë marrëveshje pretendon se themelimi i këtij Asociacioni përmes së cilit komunave me shumicë serbe do t'u krijohet më shumë hapsirë lidhjeje dhe bashkëpunimi është në funksion të realizimit të një vetëqeverisjeje më të mirë lokale, në anën tjetër Serbia dhe liderët serbë në Kosovë pretendojnë se me këtë marrëveshje krijohet një kompaktësi më e madhe ndërmjet komunave ku serbët janë shumicë, si dhe fitohet më shumë autonomi politike e qeverisëse kundrejt autoriteteve qendrore të Prishtinës, të cilat ata nuk i njohin si autoritete shtetërore, meqë Kosovën e konsiderojnë akoma krahinë të Serbisë. Pra, në njërin anë autoritetet qeveritare të Prishtinës e interpretuan marrëveshjen si diçka në të mirë të qeverisjes, pra vetëqeverisjes së serbëve në kuadër të sistemit politik të Kosovës, ndërkaq ana tjetër shpreson se përmes këtij Asociacioni komuniteti serb të jetë akoma më i mbrojtur dhe më i veçuar nga sistemi politik dhe qeverisës i Prishtinës.

Duke qenë se pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt 2008, autoritetet qeveritare të Republikës së Kosovës praktikisht e humbën kontrollin që administrata e OKB-së e kishte edhe në Veriun e banuar me shumicë serbe dhe se çdo tentativë e shtrirjes së kontrollit atje është penguar nga bashkësia ndërkombëtare, meqë nënkuptonte domosdoshmërisht përdorimin e forcës së shtetit, atëherë Prishtina dhe Bashkësia Ndërkombëtare (Kryesisht BE) synuan që përmes bisedimeve direkte ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të integrojnë komunitetin serb në sistemin politik e legal të Kosovës. Aspirata ishte që ky integrim i serbëve të bëhet duke u garantuar dhe avancuar atyre liritë dhe të drejtat themelore për ta kultivuar e mbrojtur

identitetin e tyre në shtetin e Kosovës. Para-baza e një garancie të tillë për serbët, por edhe për minoritetet tjera, është dhënë në Pakon e Ahtisaarit në të cilin në mënyrë specifike janë të përcaktuara konditat që Kosova duhet t'i plotësojë në mënyrë që të themelohet si shtet i pavarur dhe sovran. Kushti i parë ishte që "Kosova të jetë shoqëri multietnike, ku të gjithë shtetasit janë të barabartë"¹. Pra, u përjashtua mundësia që Kosova të konstruktohet si shtet i kombit shqiptar në të cilin serbët dhe minoritetet tjera "të ndiheshin të kërcënuara". Pavarësisht se ideja e Kosovës së pavarur është ide e elitës dhe popullit shqiptar të Kosovës, si dhe pavarësisht se këtë shtet shqiptarët kur e shpallën në 2 korrik 1990 dhe kur më 7 shtator 1990 miratuan Kushtetutën e Parë të Republikës së Kosovës, "Kosova u projektua si shtet demokratik i kombit shqiptar", por i cili garantonte dhe mbronte të drejtat e pakicave kombëtare², bashkësia ndërkombëtare përmes procesit të negociatave në Vienë shtetin e Kosovës e konstrukttoi si shtet qytetar shumë-etnik. Pra, shtet i të gjithë shtetasve të vet, edhe pse një pjesë e tyre, siç janë serbët, nuk e njohin atë, ndërkaq lidhshipi i tyre edhe e "lufton" diku më shumë (në veri të Kosovës) e diku në pak (në brendi).

Megjithëse Serbia mori pjesë në negociatat e Vienës në të cilat u bënë shumë kompromise lidhur me natyrën e shtetit të Kosovës (në favor të serbëve), veçanërisht në të drejtat që iu garantuan pakicave kombëtare të Kosovës (komuniteteve pakicë

¹ Neni 1, Dispozitat e përgjithshme, Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, 2 shkurt 2007.

² Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës. *Akte të Kuvendit të Republikës së Kosovës 2 korrik 1990 – 2 maj 1992: Kushtetuta e Republikës së Kosovës 7 shtator 1990*. Prishtinë: ASHAK, 2005. Neni 1, Dispozitat e përgjithshme, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 7 shtator 1990. (E njohur si kushtetuta e Kaçanikut e cila u miratua në qytetin e Kaçanikut nga deputetet e Kuvendit të Kosovës).

³ Kapitulli 1, Neni 1.2, Përkufizimi I shtetit, Kushtetuta e republikës së Kosovës, 15 qershor 2008.

siç i definon Plani i Ahtisarit), në fund Serbia e refuzoi marrëveshjen dhe njohjen e shtetit të Kosovës. Serbia edhe sot e kësaj dite pretendon se Kosova është krahinë autonome e Serbisë (edhe me kushtetutën e saj)⁴, madje se në Kosovë ndodhet “djepi i kulturës dhe religjionit të kombit serb”⁵. Që pas negociatava të Vienës, nën presionin e BE-së dhe shteteve si Gjermania, Franca dhe Britania, Serbia u detyrua që të shkojë drejt normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën, si kusht që ajo të mund të avancojë drejt integritit në Bashkimin e Evropian. Kështu në prill të 2013-ës, nën negocimin e baroneshës Ashton (shefe e atëhershme e BE-së për politike të jashtme) u arritë “Marrëveshja e parë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë”⁶.

Në kontekst të temës të cilën trajton ky punim, pas marrëveshjes së përgjithshme të 19 prillit 2013, në vazhden e negociatava në Bruksel, Kosova dhe Serbia ndër të tjera arritën edhe marrëveshjen mbi parimet e përgjithshme dhe elementet kryesore për “Themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë”⁷. Pra në funksion të normalizimit të mëtutjeshëm të marrëdhënieve Kosovë-Serbi, u arrit kjo marrëveshje e cila presupozon që t’i integrojë serbët e Kosovës brenda Republikës së Kosovës, duke u garantuar atyre hapsirë përbashkuese dhe koordinuese vet-qeverisëse lokale (përmes Asociacionit/Bashkësisë).

⁴ Kushtetuta e Republikës së Serbisë, Preambula, 2006.

http://www.srbija.gov.rs/cinjenice_o_srbiji/ustav.php?change_lang=en

⁵ Ide e propaganduar edhe sot e kësaj dite veçanërisht nga krerët e Kishës Ortodokse të Serbisë.

⁶ Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve, 19 prill 2013.

⁷ Marrëveshja mes Kosovës dhe Serbisë për Asociacionin/Bashkësinë e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, 25 gusht 2015.

A do t'i integrojë Asociacioni/Bashkësia serbët e Kosovës në sistemin politik e juridik të Republikës së Kosovës?

Që prej çlirimit të Kosovës nga Serbia (qershor 1999), pas bombardimeve të NATO-s kundër aparatit policor e ushtarak të Serbisë në Kosovë, i cili po bënte spastrim etnik në Kosovë, serbët e Kosovës të zhvendosur brendapërbrenda Kosovës, por edhe jashtë saj, nuk e kanë pranuar realitetin e ri politik të Kosovës jashtë Serbisë. Ky refuzim i serbëve ndaj Kosovës bëhet akoma më i theksuar pas shpalljes se pavarësisë së Kosovës. Të orientuar dhe ndikuar nga politika e Beogradit, serbët besojnë, apo duan të besojnë se “Kosova është ende pjesë e Serbisë”⁸. Derisa në periudhën e UNMIK-ut dhe IPVQ-ve serbët ishin më afirmativë ndaj pjesëmarrjes në qeverisjen lokale dhe qendrore në Kosovë, pas shpalljes së pavarësisë, përveç serbëve që banojnë në komunat në brendësi të Kosovës, serbët e komunave veriore refuzuan në mënyrë kategorike dhe të dhunshme çdo tetntativë të Qeverisë së Kosovës për ta shtrirë autoritetin e vet edhe në ato territore dhe atë popullsi. Ky refuzim u theksua veçanërisht pas ardhjes në pushtet të partisë së kryeministrit aktual serb Aleksandër Vuçiq (tashmë president i Serbisë), i cili në Kosovë themeloi më pastaj të ashtuquajturën “Lista Serbe”, e cila nëse mund të themi e radikalizoi refuzimin dhe kushtëzimin kundrejt institucioneve të Republikës së Kosovës. Madje, nën ndikimin e këtij formacioni të ri politik serb në Kosovë, edhe komunat me shumicë serbe që shtrihen në brendësi të Kosovës (si Graçanica dhe Shtërpca), kanë rritur qasjen refuzuese ndaj realitetit politik të Kosovës së pavarur.

⁸ Për këtë qëllim qeveria e Serbisë ka themeluar edhe një “ministri për Kosovën dhe Metohinë”, funksioni themelor i së cilës është pikërisht propagandimi i Kosovës si pjesë e Serbisë.

Pavarësisht faktit që Pakoja e Ahtisarit dhe Kushtetuta e Kosovës garantojnë të drejta të avancuara për komunitetet pakicë, veçanërisht për pakicën serbe, kjo nuk ka ndikuar në bindjen e tyre që shteti i Kosovës është edhe shtet i serbëve. Madje me Pakon e Ahtisarit dhe Kushtetutën e Kosovës, gjuhë zyrtare në të gjithë Kosovën krahas gjuhës shqipe (si gjuhë e rreth 90% e banorëve të Kosovës), u përcaktua edhe gjuha serbe⁹. Propozimi i Ahtisarit imponoi një model të decentralizimit i cili i delegon mjaft kompetenca qeverisëse pushtetit lokal. Në propozimin e Ahtisarit i kushtohet një aneks i veçantë çështjes së Decentralizimit¹⁰, dispozitat e të cilit u inkorporuan në Kushtetutë¹¹ dhe në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale¹². Në kuadër të decentralizimit, përkatësisht të ofrimit të vetëqeverisjes në nivel lokal për pakicat kombëtare, Kosova themelon komuna të reja me ligj si realizim të obligimeve të dala nga Propozimi i Ahtisarit. Përmes miratimit të Ligjit për Kufijtë Administrativë Komunal, Kuvendi i Kosovës themeloi komuna të reja me shumicë banorësh minoritarë (Graçanicë, Ranillug, Partesh, Kllokot, Mamushë, Mitrovicë Veriore), si dhe disa komunave ekzistente ku banonin pakicat ua bashkangjiti një sërë fshatrash (territoresh) të tjera të banuara me serbë, në mënyrë që ata të ishin shumicë dominante dhe qeverisëse në këto komuna (si Novobërda etj.)¹³. Këto komuna të themeluara dhe të riorganizuar veçanërisht për serbët, përveç kompetencave vetanake dhe kompetencave të deleguara nga autoritetet qendrore, në ligjin për Vetëqeverisjen Lokale iu përcaktohen

⁹ Neni 5, Gjuhët, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 qershor 2008.

¹⁰ Aneksi III, Decentralizimi, Propozimi Gjithëpërfshirës për marrëveshjen për Statusin e Kosovës, 2 shkurt 2007.

¹¹ Kapitulli X, Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 qershor 2015.

¹² Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi I Kosovës, 20.02.2008.

¹³ Neni 5, Ligji për Kufijtë Administrativ të Komunave, Kuvendi I Kosovës, 20 shkurt 2008.

edhe kompetenca të zgjeruara në fusha të cilat janë në kompetencë ekskluzive të pushtetit qendror. Këto kompetenca të zgjeruara për këto komuna të banuara me shumicë serbe lidhen me fushën e shëndetësisë, arsimit dhe përcaktimin e komandantëve të stacioneve policore¹⁴.

Sipas këtij ligji, Komuna e Mitrovicës së Veriut, Komuna e Graçanicës dhe Komuna e Shtërpcës kanë kompetenca “për ofrimin e përkujdesit dytësor shëndetësor, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve të përkujdesit shëndetësor, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajtimin e personelit dhe administratorëve të përkujdesit shëndetësor”¹⁵. Këto kompetenca të zgjeruara të cilat u janë përshkruar me ligj këtyre komunave me shumicë serbe janë kompetenca që në Kosovë ushtrohen nga autoritetet qendrore si Ministria e Shëndetësisë dhe nuk ka komunë tjetër e banuar me shqiptarë apo pakica tjera që i ushtrojnë këto kompetenca në nivel lokal.¹⁶ Në fushën e arsimit universitar, organizimit dhe funksionimi i të cilit në Kosovë është kompetencë e organeve qendrore si Ministria e Arsimit dhe Agjencionet e caktuara qeveritare, në rastin e Komunës së Mitrovicës së Veriut ligji ka përcaktuar se ka kompetencë për “shkollimin e lartë, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve shkollore, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve arsimorë”¹⁷.

Po ashtu, në fushën e kulturës, ligji përcakton se “të gjitha komunat, në të cilat komuniteti serb është shumicë, kanë kompetenca për të ushtruar përgjegjësitë për çështjet kulturore,

¹⁴ Neni 19., Kompetencat e zgjeruara komunale, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi I Kosovës, 20.02.2008

¹⁵ Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 20, Kompetencat e zgjeruara në përkujdesin dytësor shëndetësor. 04.06.2008.

¹⁶ Po aty, Neni 20.

¹⁷ Po aty, Neni 21.

duke përfshirë mbrojtjen dhe promovimin e trashigimisë kulturore dhe religjioze serbe dhe të tjerëve, brenda territorit komunal, si dhe mbështetjen e komuniteteve lokale religjioze...”¹⁸. Sikurse komunat me shumicë serbe përcaktohet se kanë “kompetenca për të ushtruar të drejta të zgjeruara për pjesëmarrjen në zgjedhjen e komandantit lokal, sipas ligjit për policinë”¹⁹.

Pra, siç mund të shohim, pushteti në Kosovë është mjaft i decentralizuar, përkatësisht komunat si bartëse të pushtetit lokal kanë një variacion të gjërë kompetencash përmes të cilave vetëqeverisin. Veçanërisht komunave në të cilat serbët janë shumicë dominante u janë deleguar dhe përcaktuar kompetenca shtesë përmes të cilave atyre u mundësohet që në një nivel mjaft të avancuar të vetëqeverisen dhe të promovojnë interesat e tyre komunitare, identitare, kulturore, ekonomike, sociale etj. Por, pavarësisht kësaj, në negociatat e Brukselit, serbët kërkuar themelimin e një Asociacioni/Bashkësie përmes të cilit komunat serbe do të lidheshin në një “trup të përbashkët politik”, i cili do të ketë kompetenca të zgjeruara për mbikqyrje të plotë të politikave të këtyre komunave mbi arsimin, shëndetësinë, ekonominë, kulturën, urbanizmin, çështjet sociale, kthimin e të zhvendosurve, ofrimin e shërbimeve etj.

Në parim dhe në realitet, të gjitha këto politika sot janë në kompetencë të komunave me shumicë serbe dhe pushteti qëndror edhe sikur të donte nuk ka të drejtë ligjore të ndikojë apo të përfshihet në këto politika. Përmes Asociacionit serbët tanimë duan t’i përbashkojnë këto përgjegjësi dhe kompetenca vetëqeverisëse tek një entitet i përbashkët juridik, i cili do të ketë një Kuvend të përbashkët për të gjithë anëtarët e tij themelues, do të ketë Kryetarin dhe Këshillin e përbërë nga 30 anëtarë, Bordin

¹⁸ Po aty, Neni 22.

¹⁹ Po aty, neni 23.

7 anëtarësh, simbolet e përbashkëta etj²⁰. Pra, serbët duan që kompetencat e tyre të zgjeruara vetëqeverisëse komunale në Kosovë t'i ushtrojnë edhe përmes një "autoriteti qendror", por i cili nuk është "qeveria shqiptare e Kosovës". Kështu, politika e Beogradit e cila u kërkon serbëve që mos ta njohin Republikën e Kosovës arriti që përmes kësaj marrëveshjeje t'i përbashkojë serbët nën një entitet juridik dhe qeverisëse dhe t'ua shtojë atyre shpresat se në Kosovë mund të jetohej dhe qeveriset edhe pa e njohur (madje duke e mohuar e luftuar) shtetin e Kosovës.

Nëse është menduar se përmes kompromist të themelimit të Asociacionit/Bashkësisë, i cili duhet thënë dallon nga të gjitha asociacionet tjera komunale në Kosovë, serbët do të afrohen dhe integrohen në shtetin kosovar, është gabuar. Interpretimi që Serbia dhe "Lista Serbe" ia kanë bërë kësaj marrëveshjeje te populli serb në Kosovë është se serbët do të jenë më autonomë kundrejt Qeverisë së Kosovës dhe se mbështetja për serbët përmes këtij Asociacioni do të jetë nga Serbia. Në një farë forme serbët e konceptojnë këtë Asociacion si pushtetin e tyre qendror, përmes të cilit ata do të kenë mundësi të ndërtojnë lidhje direkte bashkëpunimi me Serbinë dhe bashkëpunime të tjera ndërkombëtare. Pas përplasjeve të mëdha politike ndërmjet qeverisë dhe opozitës lidhur me natyrën e këtij asociacioni, Presidentja e atëhershme e Kosovës znj. Ahtifete Jahjaga iu drejtua Gjykatës Kushtetuese për t'i kërkuar sqarim mbi natyrën kushtetuese ose jo të marrëveshjes mbi parimet e Asociacionit, e cila nxori një vendim sipas të cilit një numër i konsiderueshëm aspektesh të marrëveshjes për themelimin e Asociacionit bien plotësisht apo pjesërisht në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.²¹ Mbi këtë bazë, edhe Statuti i

²⁰ Marrëveshja për Asociacionin/Bashkësinë e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, 25 gusht 2015.

²¹ Aktgjykim në rastin nr. KO130/15, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 23.12.2015.

Asociacionit i cili duhet të hartohet nga Qeveria e Kosovës duhet të jetë në përputhje me vërejtjet e Gjykatës Kushtetuese, pra që Asociacionit t'i hiqen kompetencat ekzekutive që atë e shëndrrojnë në pushtet ekzekutiv të llojit të veçantë në Kosovë. Të ndodhur në këtë situatë, Serbia dhe serbët kundërshtojnë çdo ndryshim të parimeve të përgjithshme të Marrëveshjes për Asociacionin, të nënshkruar në Bruksel, ndërkaq natyra aktuale e saj bie në kundërshtim me Kushtetutën dhe sistemin politik të Kosovës.

Pra, pas reagimit të Serbisë, qëllimi i së cilës është të mohojë shtetin e Kosovës, duke i detyruar serbët kosovarë të mos e pranojnë atë, doli që Asociacioni është entitet juridik jashtë sistemit kushtetues të Kosovës, themelimi i të cilit ka për qëllim mbajtjen edhe më tutje të serbëve të Kosovës jashtë realitetit politik të shtetit kosovar. Kështu, ose duhet të ndryshohet sistemi kushtetues i Kosovës, që nënkupton amandamentime kushtetuese në të cilat parashihet një nivel i ri i pushtetit qeverisës në Kosovës, siç është Asociacioni me kompetencat e tij ekzekutive, ose nëse Asociacioni funksionalizohet në këtë formë do të jetë një organizëm paralel politik i serbëve dhe Serbisë në Kosovë. Në të dyja rastet serbët do të mbeten të veçuar dhe të larguar nga integrimi në shoqërinë dhe shtetin kosovar. Edhe nëse legalizohet Asociacioni dhe përfshihet në Kushtetutë, serbët do të kenë prirje të kërkojnë edhe më tutje autonomi nga Prishtina dhe kështu do të shkohet drejt tralizimit të skenarit të Serbisë për ndarjen e Kosovës.

Refleksione përfundimtare

Nëse synimi i bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë ka qenë që Kosova të jetë shtet i të gjithë shtetave të saj, pra shqiptarëve dhe pakicave tjera kombëtare serbëve, turqve, boshnjakëve, romëve, ashkalinjve, egjiptasve, goranëve, malazezëve etj., atëherë ky qëllim është realizuar në masën mbi 90%. Janë vetëm serbët e Kosovës, veçanërisht ata të Veriut të Kosovës të cilët nuk e kanë njohur realitetin e ri politik e kushtetues të Kosovës dhe këtë realitet duan ta mohojnë edhe sot e kësaj dite. Kjo ndodhë për shkak të ndikimit të vazhdueshëm të Serbisë në Kosovë. Bashkësia ndërkombëtare, veçanërisht BE-ja është mashtruar duke besuar se duke u bërë koncesione politike dhe qeverisëse serbëve të Kosovës, Serbia do të shkojë drejt njohjes formale të pavarësisë së Kosovës, pavarësisht faktit se Serbisë i është vënë kusht normalizimi i marrëdhënieve me Kosovën për t'u integruar në BE.

Për 100 vjet Kosova është projektuar dhe propaganduar si mit në Serbi. Për 100 vjet Serbia ka realizuar projekte për spastrimin etnik të Kosovës nga shqiptarët dhe kolinizimin e saj me serbë. Viti 1999 ishte kulmimi i këtij projekti shekullor serb i cili kulmoi me shpërnguljen nga Kosova të mbi 1 milionë shqiptarëve dhe vrasjen e mbi 11 mijë civilëve shqiptarë, përfshirë miliarda dëme materiale. Pa dyshim pas vitit 1999 ka pasur shpërngulje të serbëve nga Kosova, si pasojë e frikës së tyre të revanshit të mundshëm të shqiptarëve të rikthyer në vatrat e tyre. Ka pasur edhe vrasje të serbëve. Por nuk ka ekzistuar asnjëherë para as pas vitit 1999 në Kosovë një plan apo projekt i shqiptarëve, apo ndonjë subjekti politik shqiptar për spastrimin e Kosovës nga serbët, ta zëmë siç kanë ekzistuar planet serbe për spastrimin

etnik të shqiptarëve, si ai i Çubrilloviqit²², Memorandumi i Akademisë Serbe etj. Para vitit 1999 kjo do të ishte e pamundur sepse me Kosovën kanë qeverisur serbët, pavarësisht se ishin pakicë, ndërsa pas vitit 1999 Kosova është qeverisur nga misioni më i madh i OKB-së deri atëherë kudo në botë - UNMIK. Serbët e shpërngulur duhet të kthehen në Kosovë, por jo mbi planet kolonizuese të shekullit XX të Serbisë, apo shifrat që proklamohen sot nga Beogradi për kthimin e mbi 250 mijë serbëve të shpërngulur nga Kosova.

Modeli i decentralizimi i cili iu imponua Kosovës nga Pako e Ahtisarit deri më sot më shumë ka ndikuar në dezintegrimin e tyre se sa në përgatitjen e rrugës që serbët ta konsiderojnë shtetin e Kosovës edhe si shtetin e tyre. Kjo sepse Serbisë nuk i është imponuar njohja e Kosovës si kusht që serbët e Kosovës të bëhen bashkëthemelues të shtetit të Kosovës. Duke e shpërfillur shovenizmin e politikës aktuale serbe, bashkësia ndërkombëtare ka çuar drejt rrezikimit të funksionalitetit të shtetit kosovar. Më autonominë kulturore dhe ekskluzivitetin identitar serb që Pakoja e Ahtisarit i ka dhënë Kishës Ortodokse Serbe të Kosovës, përmes krijimit të të ashtuquajturave “zonave të mbrojtura”²³, me vendet e rezervuara/garantuara në Kuvendin e Kosovës (vende që janë në disproporcion të plotë me numrin e popullësisë serbe në Kosovë), me krijimin e komunave të reja serbe (duke bashkuar artificialisht territore dhe popullësi serbe), me kompetencat e shtuara për komunat me shumicë serbe (kompetenca që nuk u janë dhënë komunave të tjera joserbe) dhe me krijimin e një Asociacioni/Bashkësie me Komuna Serbe, Bashkësia Ndërkombëtare ka bërë që serbët e Kosovës ta besojnë iluzionin se në Kosovë mund të jetohet duke mos i njohur

²² Shih: Vasa Çubrilloviç, *Problemi I pakicave kombëtare në Jugosllavinë e re* (Prishtinë: Zëri I Kosovës, 1987).

²³ Aneksi V, *Trashigimia fetare dhe kulturore, Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës*, 2 shkurt 2007.

shqiptarët dhe duke mos e njohur faktin që si shumicë ata kanë pasur vullnetin demokratik ta shpallin pavarësinë dhe ta ndërtojnë shtetin qytetar.

Diskriminimi pozitiv apo afirmativ, siç po thuhet që u është bërë serbëve që pas 1999-ës e veçanërisht në kornizën e imponuar për shtetin kosovar, do të bëjë që ata edhe më tutje ta shohin veten të privilegjuar në raport me popullin shumicë në Kosovë, siç e kanë parë gjatë gjithë shekullit XX. Pavarësisht që historikisht kanë qenë pakicë në Kosovë, serbët gjatë gjithë shekullit XX i kanë qeverisur shqiptarët dhe rasti që kjo ndjenjë supremacie të hiqet ka qenë pas vitit 1999. Serbët vetëm duke e kuptuar që në Kosovë janë qytetarë të barabartë, me të drejta që u mundësojnë ruajtjen dhe kultivimin e identitetit të tyre kombëtar, mundet që të integrohen dhe ta njohin shtetin dhe shoqërinë e lirë kosovare. Nëse Bashkësia Ndërkombëtare, nën ndikimin e Serbisë do të vazhdojë t'i veçojë serbët në Kosovë me mekanizma dhe entitete dalluese nga pjesa tjetër e popullit, atëherë është e kotë aspirata integruese për ta. Në këtë vazhdë, i ashtuquajtimi decentralizim, ata më shumë do t'i dezintegrojnë nga shteti kosovar se sa do t'i përfshijë brenda tij.

Bibliografia

Aktgjykim në rastin nr. KO130/15, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 23 dhjetor 2015. (http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjk_ko_130_15_shq.pdf , vizituar për herë të fundit 13.06.2017).

Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës. *Akte të Kuvendit të Republikës së Kosovës 2 korrik 1990 – 2 maj 1992: Kushtetuta e Republikës së Kosovës 7 shtator 1990*. Prishtinë: ASHAK, 2005.

Çubrilloviç, Vasa. *Problemi i pakicave kombëtare në Jugosllavinë e re*. Prishtinë: Zëri i Kosovës, 1987.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 qershor 2008. (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702> , vizituar për herë të fundit më 13.06.2017).

Kushtetuta e Republikës së Serbisë, Beograd, 2006. (http://www.srbija.gov.rs/cinjenice_o_srbiji/ustav.php?change_lang=en_, vizituar për herë të fundit më 13.06.2017).

Ligji për kufijtë administrativë, Kuvendi i Kosovës, 20 shkurt 2008.

(http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L041_al.pdf , vizituar për herë të fundit më 13.06.2017).

Ligji për Vetëqeverisjen lokale, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 20 shkurt 2008. (http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_al.pdf , vizituar për herë të fundit më 13.06.2017).

Marrëveshja për themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, Bruksel, 25 gusht 2015. (http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Asociacioni_perkthimi_shqip_-_final.pdf , vizituar për herë të fundit më 13.06.2017).

Marrëveshja e parë Mbi Parimet për Normalizimin e Marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Bruksel, 2013. (<http://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8892> , vizituar për herë të fundit më 14.06.2015)

Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, 2 shkurt 2007. (<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Propozim%20per%20Statusin%20e%20Kosoves.pdf> , vizituar për herë të fundit më 14.06.2017).